



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:081292 **C. nr. 350/2018**
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05484668

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditëses “ I.....” sh.a., me seli në Fushë Kosovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson z. F.S. Zyrtar i Lartë Ligjor, kundër të paditurit H.K. me objekt kontesti lirim dhe pronës dhe shpërblimin e dëmit, me vlerë të kontestit 5,450.00 euro, pas mbajtjes së seancës përgatitore, me datë 21 Mars 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses “ I.....” sh.a., me seli në Fushë Kosovë, me të cilën ka kërkuar që në emër të shpërblimit të dëmit material për shfrytëzimin e pronës, në mënyrë të pa lejuar për sipërfaqen 200 m² pjesën e ngastrës kat. Nr.747 ZK Prizren, të kompensohet paditësja në shumën e përgjithshme prej 5,450.00 euro si kërkesë e pa bazuar.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja “ I.....” sh.a., me seli në Fushë Kosovë, pranë kësaj gjykate me datën 16 Mars 2018, ka parashtruar padi, me të cilën ka theksuar se i padituri në mënyrë të vetëdijshme për përfitime personale i ka shkaktuar dëm material paditëses, duke kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurin që për shkak të pasurimit të pabazë ligjore në dëm të paditëses – shpërblimin e dëmit për sipërfaqen e uzurpuar të cilën e shfrytëzon në sipërfaqe të përgjithshme prej 200 m², për periudhën nga muaji Janar 2014 deri 31 Mars 2018 gjegjësisht 51 muaj në shumë të përgjithshme prej 5,450.00 euro, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe sipërfaqen e përgjithshme të uzurpuar prej 200 m², pjesë e ngastrës kad. me numër 747 me fletë poseduese 253 ZK Prizren, që të bëjë lirim dhe pronës nga sendet dhe njerëzit, dhe të njëjtën t’ia dorëzoj paditësit në gjendjen e mëparshme.

Seanca përgatitore është mbajtur në mungesë të palës së paditurit.

Me datën 15 Mars 2024, gjykata ka mbajtur seancën përgatitore në këtë çështje kontestimore, ku këtë seancë e ka mbajtur në mungesë të paditurit këtu H.K. dhe në këtë

seancë i autorizuari i paditëses z. F.S. i ka dorëzuar gjykatës parashtrësën mbi tërheqjen e padisë dhe kërkesëpadisë me arsyetimin se duke i marr për bazë vendimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë duke i refuzuar paditë dhe kërkesëpaditë e të njëjtës natyrë, kanë ardhur në përfundime se në rastet kur nuk konstatohet se ka dëm material të heqin dorë nga padia dhe kërkesëpadia. Me qenë se prona është liruar në formë të dhunshme, kërkoj nga kjo gjykatë që të obligoj që secila palë ti bartë shpenzimet e veta.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 149 dhe 388, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në pikën një të këtij dispozitivi të aktgjykimit.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave nga neni 450 dhe 463 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr. 350/2018, datë 21 Mars 2024

B.profesional
Iilir Sërtollaj

Gjyqtari
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimimit të këtij aktgjykimi.